



Pranimar / Doretuar Primenar / Predato Received / Delivery	07 - 11	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSH/OK	6771/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.872/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.872/2022 të datës 07.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted]

kundër Vendimit me Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike *Transferim në rast riskstruktumi*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 07.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.872/2022 e datës 07.10.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, fizikisht më datë 07.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5956/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e tij për shkak të restrukturimit të institucionit në pozitën „Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshëm“ në Ministrinë e Shëndetësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5956/2022 të datës 07.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datë 26.09.2022; Referencë

për ankuesin me numër Ref: 109/08/2004; Vendimin me Nr. 116/2004 i datës 05.01.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të kontratës 03/2004 e datës 01.01.2004; Letër referencës e datës 10.12.2007; Kontratën e punës me Nr.5385/0108 e datës 09.05.2007; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të kontratës 152/2010 e datës 19.07.2010; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr. Ref:010/2008 e datës 01.08.2008; Vendimin me Nr. 97/08 i datës 28.07.2008; Vendimin me Nr. Ref:274/2014 i datës 30.04.2004; Vendimin me Nr. 588/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr. 3/14 i datës 04.03.2014; Vendimin me Nr. Ref:133/2016; Akt Emërimit AE.Nr.27/2021 i datës 08.04.2021; Vendimin me Nr. 138/2022 i datës 15.09.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Kërkesën për dhënien e një kopje të dosjes së ankuesit e parashtruar nga ankuesi më datë 27.09.2022 për Zëvendësuesen e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Kërkesë për monitorim të emërimeve të paligjshme në pozitat udhëheqëse në MPJD nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Sindikale të Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm e datës 10.03.2022 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 05.40.2022 nga Emailin e datës 05.04.222 nga A.Çollaku; Kërkesë për inspektim të disa vendimeve për caktimin e zyrtarëve të ndryshëm brenda MPJD e datës 10.05.2022 nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Sindikale të Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm për Sekretaren e Përgjithshëm të MPB; Ankesën ndaj sistemeve në mënyrë të kundërshtime në MPJD e datës 17.05.2022 nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Sindikale të Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për anulimin e konkurseve të shpallura në MPJD e datës 28.07.23022 e parashtruar nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Sindikale të Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm për Agjencinë Kundër Korrupsionit; Vendimin me Nr. 187 i datës 19.05.2017; Shkresë informuese për rrjedhat në MPJD e datës 01.08.2022 nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Sindikale të Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm për Ministrinë e MPJD-së; Kërkesën për ndaljen e shkeljeve ligjore-sistemit në mënyrë të kundërligjshme në MPJD e datës 01.06.2022 nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Sindikale të Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm për Presidenten, Kryeministren e Kosovës, Ministren e MPJD, Komisionin për Punës të Jashtëm të Kuvendit, Avokatin e Popullit, Auditorin e Përgjithshëm, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për informim e datës 20.04.2021; Diplomën me Nr. 1385 për ankuesin; Diplomën me Nr. 127/21 për ankuesin; Certifikatën e datës 30.09.2010; Certifikatën për periudhën 01-05.06.2009; Certifikatën e darës 22.12.2009; Certifikatën nga USAID; Certifikatën nga Agjencia e Regjistrimit Civil; Certifikatën për periudhë 13-16.02.2012, 07-08.02.2012; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2017 i datës 24.12.2017, Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2016 i datës 25.11.2016; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2015 i datës 15.12.2015; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2013 i datës 08.11.2013; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2011 i datës 30.10.2011; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2020 i datës 20.10.2021; Emailin e darës 21.06.2022 nga ankuesi për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundoj *procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit* *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me AE.Nr.27/2021 të datës 08.04.2021 ka qenë i emëruar në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila pozitë nuk është paraparë si i tillë me Rregulloren e re Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Për shkak të ristrukturimit gjegjësisht bashkimit të dy ministrive kanë qenë dy nëpunës civil që kanë mbajtur pozitën e Udhëheqësit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, ankuesi dhe nëpunësi civil i cili ka qenë në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në ish Ministrinë e Diasporës dhe që të dytë pas njoftimit të Divizionit të Burimeve Njerëzore kanë shpreh preference për sistemim në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme në MPJD, rrjedhimisht ankuesi ka hyr në procesin e transferimit për shkak të ristrukturimit ku i njëjti sipas raportit me numër protokoll 596 të datës 19.04.2022 të Komisionit të Ristrukturimit, gjegjësisht në bazë të formularit të vlerësimit ka marr gjithsejtë 58 pikë duke u vlerësuar me më pak pikë së sa kandidati tjetër i cili ka marrë gjithsej 78 pikë, andaj Komisioni i Ristrukturimit ka konstatuar se ankuesi nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme të miratuara nga DMZP-ja për asnjë pozitë të lirë për Drejtor të Departamenteve në MPJD.

Ankuesi me datë 10.08.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së konkurseve për pozitat e Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve në MPJD dhe me datë 25.07.2022 kundër heshtjes administrative dhe mos sistemimit për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës Këshilli gjatë vendosjes se ankesës së ankuesit të datës 25.07.2022 ka pranuar si provë shtesë edhe Vendimin me numër Nr.138/2022 dhe numër protokoll 1372 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë lidhur me sistemimin e ankuesit në pozitën „Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshëm “në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka shfuqizuar Vendimin Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke e obliguar Komisionin e Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të rishqyrtoj rastin e sistemimit të ankuesit.

Andaj nisur nga gjendja faktike si me lartë, dhe duke qenë se objekti i ankesës A.nr.872/2022 i datës 07.10.2022 i referohet vendimit i cili është shfuqizuar nga Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, Kolegji mbi bazën e këtyre rrethanave vlerëson se objekti i ankesës respektivisht qëllimi i ankesës se ankueses me numër A.nr.872/2022 të datës 07.10.2022 është bërë i pamundur - kotë, kështu që në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative cili përcakton se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”, Kolegji vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës së ankuesit me numër A.nr.872/2022 të datës 07.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.872/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

